



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 45**

**Prishtinë, më 11.05.2016, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj Milka Vuletiq, Sasha Milosavljević, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

**Munguan:** Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

**Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje :** përfaqësues i KDI-së – Artan Murati, Përfaqësues nga OSBE-ja Senad Karaahmetovic, përfaqësues i Ambasadës Zvicrane në Kosovë – Hajrudin Skenderi, konsultant i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun -Celal Iliaz,

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6.04.2016, 19.04.2016 dhe 27.04.2016;**
- 3. Identifikimi i temave me interes të komuniteteve lidhur me vizitën studimore në Parlamentin e Republikës së Kroacisë;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6.04.2016, 19.04.2016 dhe 27.04.2016;**

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me dat. 6.04.2016, 19.04.2016 dhe 27.04.2016, pa vërejtje.

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim planifikon realizimin e vizitës së Kuvendit të Republikës së Kroacisë nën organizim të OSBE-së e cila është paraparë me Planin e punës së Komisionit për vitin 2016, në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit ndër parlamentar.

Propozimi i saj ishte që Komisioni të takohet me Presidentin e Parlamentit Kroat, Davorin Mlakar, njëkohësisht kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme, me Komisionin për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave Kombëtare zot. Furio Radin, me përfaqësuesit e Zyrës për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave si dhe përfaqësuesit e Këshillit për pakicat Kombëtare të Qeverisë së Republikës së Kroacisë. Qëllimi jonë është të iniciohen shumë çështje që ka të bëjë me të drejtën pasurore – juridike, arsimimi i komuniteteve dhe integrimi i tyre në Institucionet shtetërore. Njëkohësisht të caktohen takime bilaterale, me qëllim që secili grupacion të zhvillojë temat për çështjet që ata i preokupojnë.

Kryesuesja, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të definojnë propozim - temat të cilat do të zhvillohen, gjatë vizitës me karakter pune në Kuvendin e Republikës së Kroacisë.

**Sasa Milosavljeviq**, propozoi që të zhvillohen bisedime rreth temave për zgjedhjen e çështjes së pronës, arsimimit dhe përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, në shtetin Kroat. Gjegjësisht, të shkëmbehen përvojat me komisionin homolog të Kroacisë, përbërja dhe përgjegjësit e saja. Të diskutohet lidhur me ligjet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, e cila përvojë do të jetë kontributdhënëse gjatë punës tonë në Komision.

**Agim Çeku**, specifikoi disa tema të veçanta; në takimin me kryetarin e Parlamentit Kroat të diskutohet për Infrastrukturën ligjore, të dhënat për materien e ligjeve që ka miratur Parlamenti Kroat. Njëherit, të njihemi me praktikën e punës së Parlamentit Kroat, nga se gjatë javës shtjellohen debate të ndryshme, nëdrsa votimi bëhet ditën e premte.

Propozoi të njihemi me zhvillimin e punës së Komisionit për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave, është komisioni i përhershëm apo funksional, shqyrtojnë të gjitha ligjet të cilat vijnë në Parlament. Gjithashtu, të diskutohet për pronën, arsimimin, rindërtimin e shtëpive për komunitete dhe ingrimin i tyre në sistemin shtetëror.

Veçoi se se duhet të bisedohet me kryetarin e Parlamentit Kroat, lidhur me formimin e Grupit të Miëqsisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kroacisë, sepse mungon praktika e tillë e bashkëpunimit.

Ishte i mendimit të mbahet takim me Këshillin për Pakicat Kombëtare, zot, Milorad Pupavac, i cila ka përvojë shumë vjeqare dhe praktikën e tilla janë në interes të shkëmbimit të përvojave nga fusha e zgjedhjes së të drejtave të komuniteteve jo shumicë dhe mbrojtjes së interesave të tyre. Në fund, dha propozim që të njihemi me praktikën e punës së Parlamentit të Kroacisë, pas pranimit të Kroacisë në BE.

**Veton Berisha**, sa i përket vizitës studimore, është i interesuar të njihet për së afërmi me praktikën e punës Parlamentare të Kroacisë si dh me punën e Komisionit për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave. Ai propozoi të kemi takime me përfaqësues të Zyrës për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve si dhe përfaqësuesit e Këshillit për pakicat Kombëtare të Qeverisë së Republikës së Kroacisë, me qëllim të marrjes së informatave për gjendjen e jetesës së komuniteteve jo shumicë, siq janë, arsimimi, punësimi dhe përfaqësimi i tyre në institucionet shtetërore, në komuna . Në bazë të Kushtetutës, sa vende janë rezervuar në Parlamentin Kroat, për komunitetet jo shumicë.

*Pas konsultimeve për caktimin e temave gjatë realizimit të vizitës në Parlamentin Kroat, Komisioni miratoi këto pika:*

- I. Shkëmbimi i përvojave në lëmin e zgjedhjes së të drejtave të komuniteteve jo shumicë dhe mbrojtja e interesave të tyre në Republikën e Kroacisë.
- II. Dispozitat kushtetuese për të drejtat e komuniteteve jo shumicë, infrastrukturën ligjore
- III. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e Komisionit për Pakicat Kombëtare
- IV. Rregullativin ligjor për çështjet e marrëdhënjëve pronësore – jurike, arsimimi i komuniteteve dhe ingrimi i tyre në sistemin shtetëror.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

**Jasmina Zhivković**